SONY

4-299-353-**12**(1) (AL)

Sistem kinemaje në shtëpi me DVD

Udhëzimet e përdorimit

HDMI

©2012 Sony Corporation

DAV-TZ140

AL

PARALAJMËRIM

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, kjo aparaturë nuk duhet të ekspozohet ndaj shiut ose lagështirës.
Për të reduktuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, kjo aparaturë nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimeve ose spërkatjeve me ujë dhe mbi aparaturë nuk duhen vendosur objekte të mbushura me lëng, siç janë vazot.
Për të reduktuar rrezikun e zjarrit, mos mbuloni hapësirën e ajrimit me gazeta, mbulesa tavoline, perde, etj.
Mos vendosni mbi aparaturë burime me flakë të pambrojtur siç janë qirinjtë e ndezur.
Duke qenë se spina kryesore përdoret për të shkëputur njësinë nga rrjeti elektrik, lidheni njësinë me një prizë lehtësisht të arritshme rryme të drejtpërdrejtë. Nëse vini re një anomali në njësi, shkëputni menjëherë prizën kryesore nga priza e rrymës së drejtpërdrejtë.
Spina e rrjetit elektrik përdoret për të shkëputur këtë pajisje nga priza e rrymës së drejtpërdrejtë, prandaj pozicionojeni këtë pajisje në një vend ku mund të shkëputet lehtësisht nga priza.
Mos e instaloni pajisjen në një hapësirë të kufizuar, si në një raft librash ose në një mobilie inkaso.
Mos ekspozoni bateritë ose aparaturën me bateri të instaluara ndaj nxehtësisë së tepruar siç janë drita e diellit, zjarri ose të ngjashme me to.
Njësia nuk shkëputet nga rrjeti elektrik për sa kohë që është e lidhur me prizën e rrymës së drejtpërdrejtë, edhe nëse njësia vetë është e fikur.
Për të parandaluar lëndimet, kjo aparaturë duhet të montohet mirë në dysheme/mur në përputhje me udhëzimet e instalimit.
Vetëm për përdorim në ambiente të brendshme.

KUJDES
Përdorimi i instrumenteve optike me këtë produkt do të rrisë rrezikun ndaj syve.

Për modelet evropiane

CLASS 1 LASER PRODUCT
LUOKAN 1 LASERLAITE
KLASS 1 LASERAPPARAT

Kjo pajisje klasifikohet si produkt CLASS 1 LASER. Kjo shenjë ndodhet në pjesën e jashtme të pasme.

Njoftim për klientët: Informacioni i mëposhtëm aplikohet vetëm për pajisjet e shitura në vendet ku aplikohen direktivat e BE-së.
Prodhuesi i këtij produkti është Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni. Përfaqësuesi i autorizuar për EMC dhe sigurinë e produktit është Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çdo çështje shërbimi ose garancie, ju lutemi referojuni adresave që jepen në dokumentet e veçanta të shërbimit ose garancisë.

Kjo pajisje është testuar dhe është gjendur konform limiteve të përcaktuara në Direktivën EMC për përdorimin e një kablloje lidhëse më të shkurtër se 3 metra. (Vetëm modelet evropiane)

Për klientët në SH.B.A.

Regjistri i zotëruesit
Modeli dhe numrat serialë ndodhen në pjesën e jashtme të pasme të njësisë. Regjistrojini këto numra në hapësirën e dhënë më poshtë. Referojuni atyre sa herë që kontaktoni me shitësin tuaj Sony në lidhje me këtë produkt.

Numri i modelit DAV-TZ140
Numri i serisë_____

Deklarata e mëposhtme FCC aplikohet vetëm për versionin e këtij modele të prodhuar për shitje në SH.B.A. Versionet e tjera mund të mos jenë konform rregulloreve teknike FCC.

SHËNIM:
Kjo pajisje është testuar dhe është gjendur konform limiteve për pajisjet dixhitale të Klasit B, në përputhje me pjesën 15 të Rregulloreve FCC. Këto limite janë përcaktuar për të ofruar mbrojtje të arsyeshme kundër ndërhyrjeve të dëmshme në një instalim në shtëpi. Kjo pajisje gjeneron, përdor dhe mund të përhapë energji të frekuencave radio dhe mund të shkaktojë interferenca të dëmshme me komunikimet radio nëse nuk instalohet dhe përdoret në përputhje me udhëzimet. Megjithatë, nuk garantohet që nuk do të ndodhë interferencë në një instalim të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton interferenca të dëmshme në marrjen radiofonike ose televizive, që mund të përcaktohet duke ndezur dhe fikur pajisjen, përdoruesi inkurajohet të përpiqet të korrigjojë interferencën përmes një ose më shumë prej masave të mëposhtme:
– Të riorientohet ose zhvendoset antena marrëse.
– Të rritet hapësira ndarëse mes pajisjes dhe marrësit.
– Të lidhet pajisja në një prizë në një qark të ndryshëm nga ai ku është lidhur marrësi.
– Konsultohuni me shitësin ose një teknik televizori/radioje me përvojë për asistencë.

KUJDES
Kini kujdes që ndryshimet apo modifikimet që nuk janë të miratuara shprehimisht në këtë manual të mos zhvlerësojnë të drejtën tuaj për të përdorur këtë pajisje.

Udhëzime të rëndësishme për sigurinë
1) Lexojini këto udhëzime.
2) Ruajini këto udhëzime.
3) Tregoni kujdes për të gjitha paralajmërimet.
4) Ndiqini të gjitha udhëzimet.
5) Mos e përdorni këtë aparaturë pranë ujit.
6) Pastrojeni vetëm me pëlhurë të thatë.
7) Mos bllokoni hapësirat e ajrimit. Instalojeni në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.
8) Mos e instaloni pranë burimeve nxehtësie siç janë radiatorët, regjistruesit e nxehtësisë, sobat ose pajisje të tjera (duke përfshirë edhe amplifikatorët) që prodhojnë nxehtësi.
9) Mos shpërfillni qëllimin e sigurisë së spinës së polarizuar ose të tokëzuar. Një spinë e polarizuar ka dy kunja ku njëra është më e gjatë se tjetra. Një spinë e tokëzuar ka dy kunja dhe një të tretë për tokëzim. Kunji i gjerë ose kunji i tretë ofrohen për sigurinë tuaj. Nëse spina e dhënë nuk futet në prizën tuaj, konsultohuni me një elektricist për zëvendësimin e prizës së vjetër.
10) Mbrojeni kordonin e rrymës nga shkelja ose përthyerja veçanërisht te spinat, prizat, si dhe te pika ku ato dalin nga aparatura.
11) Përdorni vetëm pjesët/aksesorët e specifikuar nga prodhuesi.
12) Përdoreni vetëm me tryezën me rrota, portmanonë, këmbalecin, mbajtësen ose tavolinën e specifikuar nga prodhuesi, ose që shitet së bashku me aparaturën. Kur përdoret tryezë me rrota, tregoni kujdes gjatë lëvizjes së kombinimit tryezë me rrota/aparaturë për të shmangur lëndimet nga përmbysja.

13) Shkëputeni këtë aparaturë nga priza gjatë stuhive me rrufe ose kur nuk përdoret për periudha të gjata kohore.

14) Për të gjitha shërbimet drejtojuni personelit të kualifikuar të shërbimit. Kërkohet shërbim kur aparatura është dëmtuar në ndonjë mënyrë, si p.sh. nëse është dëmtuar kordoni i furnizimit me rrymë ose priza, nëse mbi aparaturë janë derdhur lëngje ose kanë rënë objekte, nëse aparatura është ekspozuar ndaj shiut ose lagështirës, nëse nuk punon siç duhet ose nëse është rrëzuar.

Për modelet e Amerikës së Veriut, Meksikës dhe Brazilit

Ky simbol përdoret për të njoftuar përdoruesin mbi praninë e ndonjë „rryme të rrezikshme" të paizoluar brenda produktit që mund të jetë e një përmase të mjaftueshme për të përbërë rrezik goditjeje elektrike për personat.

Ky simbol përdoret për të njoftuar përdoruesin mbi praninë e udhëzimeve të rëndësishme të përdorimit dhe mirëmbajtjes (shërbimit) në broshurat që shoqërojnë pajisjen.

Për klientët në Evropë, Rusi dhe Australi

Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sistem grumbullimi të diferencuar)
Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se ky produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, do të dorëzohet pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.
Aksesorët e aplikueshëm: Telekomanda.

Europe Only

Hedhja e baterive të përdorura (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sistem grumbullimi të diferencuar)
Ky simbol mbi bateri ose mbi paketim tregon se bateria e dhënë me këtë produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake.
Në disa bateri, ky simbol mund të përdoret i kombinuar me një simbol kimik. Simbolet kimike për zhivën (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0.0005% zhivë ose 0.004% plumb. Duke u siguruar që këto bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore.
Në rast produktesh të cilat për arsye sigurie, rendimenti apo integriteti të dhënash kërkojnë lidhje të qëndrueshme me një bateri të inkorporuar, kjo bateri duhet të zëvendësohet vetëm nga personel i kualifikuar shërbimi. Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë, dorëzojeni produktin në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurt të baterisë nga produkti. Dorëzojeni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura.
Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti ose baterie, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Markat tregtare

Ky sistem përmban dekoderë rrethues matricë të përshtatur Dolby* Digital dhe Dolby Pro Logic.
* Prodhuar me licencë nga Dolby Laboratories. Dolby, Pro Logic dhe simboli me dy „D" janë marka tregtare të Dolby Laboratories.
Ky sistem përmban teknologji High-Definition Multimedia Interface (HDMI™), në shqip: ndërfaqe multimediale me definicion të lartë. HDMI, logoja HDMI dhe High-Definition Multimedia Interface janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të HDMI Licensing LLC në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera.

„PlayStation" dhe „PS3" janë marka tregtare të regjistruara të Sony Computer Entertainment Inc.

„BRAVIA" është markë tregtare e Sony Corporation.

Patentat dhe teknologjia koduese audio MPEG Layer-3 janë të licencuara nga Fraunhofer IIS dhe Thomson.

Windows Media është markë tregtare ose markë tregtare e regjistruar e Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe/ose vende të tjera.
Ky produkt përmban teknologji që janë subjekt i disa të drejtave të pronësisë intelektuale të Microsoft. Ndalohet përdorimi ose shpërndarja e kësaj teknologjie jashtë këtij produkti pa licencën/licencat përkatëse nga Microsoft.

MBI MPEG-4 VISUAL: KY PRODUKT LICENCOHET SIPAS LICENCËS SË PORTOFOLIT TË PATENTËS SË MPEG-4 VISUAL PËR PËRDORIM PERSONAL DHE JOTREGTAR NGA NJË KONSUMATOR PËR DEKODIMIN E VIDEOVE NË PËRPUTHJE ME STANDARDIN E MPEG-4 VISUAL („MPEG-4 VIDEO") QË JANË KODUAR NGA NJË KONSUMATOR I PËRFSHIRË NË NJË AKTIVITET PERSONAL DHE JOTREGTAR DHE/OSE ËSHTË MARRË NGA NJË OFRUES I SHËRBIMIT VIDEO I LICENCUAR NGA MPEG LA PËR TË OFRUAR MPEG-4 VIDEO.
NUK JEPET OSE NUK NËNKUPTOHET ASNJË LICENCË PËR ÇFARËDO PËRDORIM TJETËR.
INFORMACION SHTESË, DUKE PËRFSHIRË INFORMACIONIN QË LIDHET ME LICENCIMIN DHE PËRDORIMIN PROMOCIONAL, TË BRENDSHËM DHE TREGTAR, MUND TË MERRET NGA MPEG LA, LLC. SHIHNI http://www.mpegla.com/

Të gjitha markat e tjera tregtare janë marka të zotëruesve të tyre përkatës.

Mbi këto udhëzime përdorimi

„DVD" mund të përdoret si term i përgjithshëm për DVD VIDEO, DVD+RW/DVD+R, dhe DVD-RW/DVD-R.

Sistemi kalon automatikisht në modalitet gatishmërie.
Kur sistemi është në modalitetin e pauzës, ndalimit, hapjes ose modalitetin e diskut, sistemi do të kalojë në modalitetin e gatishmërisë automatikisht pas 30 minutash.

Disqet që mund të luhen

DVD	DVD-VIDEO DVD-ROM DVD-R/DVD-RW DVD+R/DVD+RW
CD	CD-DA (CD muzikore) CD-ROM CD-R/CD-RW VIDEO CD Super VCD

Disqet CD ose DVD nuk do të luhen nëse nuk janë finalizuar siç duhet. Për më shumë informacion, referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me pajisjen e regjistrimit.

Disqet që nuk mund të luhen
- Disqet Blu-ray
- DVD-të HD
- DVD-RAM-et
- Disqet DVD Audio
- PHOTO CD-të
- CD-të Super Audio
- Pjesët me të dhëna të CD-Extra-ve
- Materiali audio brenda DualDisc-eve
- DVD-R/DVD-RW/DVD+R/DVD+RW në modalitetin VR (video regjistrim)
- DVD-R/RW i përputhshëm me CPRM (Content Protection for Recordable Media) në shqip: mbrojtja e përmbajtjes për mjetet e regjistrueshme, i sinjalizuar si disk për një kopjim

Shënimet mbi disqe
Ky produkt është projektuar të riprodhojë disqe që janë konform me standardin e kompakt-diskut (CD). DualDisc-ët dhe disa disqe muzikore me teknologji për mbrojtjen e të drejtave të autorit nuk janë konform me standardin e kompakt-diskut (CD). Prandaj, këto disqe mund të mos jenë të përputhshëm me këtë produkt.

Shënim mbi përdorimin e riprodhimit të një DVD-je
Disa funksione përdorimi të riprodhimit të një DVD-je mund të jenë bllokuar qëllimisht nga prodhuesit e softuerit. Duke qenë se ky sistem e luan një DVD sipas përmbajtjes të projektuar të diskut nga prodhuesit e softuerit, disa veçori të riprodhimit mund të mos jenë të disponueshme.

Shënim mbi DVD-të me dy shtresa
Figura dhe zëri i riprodhuar mund të ndërpriten për një çast kur kalohet nga një shtresë në tjetrën.

Kodi rajonal (vetëm për DVD VIDEO)
Sistemi juaj ka një kod rajonal të printuar në pjesën e pasme të njësisë dhe do të luajë vetëm DVD VIDEO (vetëm riprodhim) të etiketuara me të njëjtin kod rajonal ose ALL.

Shënim mbi CD-të me disa sesione
Ju mund të luani vetëm sesionin e parë të një disku me disa sesione.

Llojet e skedarëve që mund të luhen

Video

Formati i skedarit	Prapashtesat
Video MPEG4[1)]	„.mp4," „.m4v"
Video Xvid[2)]	„.avi"

Muzikë

Formati i skedarit	Prapashtesat
MP3 (MPEG1 Audio Layer 3)[3)]	„.mp3"
WMA[4)]	„.wma"
AAC [5)]	„.m4a"

Foto

Formati i skedarit	Prapashtesat
JPEG	„.jpg," „.jpeg," „.jpe"

1) AVC nuk është format i përputhshëm.
2) Nuk disponohet në modelet amerikane.
3) Formati MP3PRO nuk është i përputhshëm.
4) Formatet WMA DRM, WMA Lossless ose WMA PRO nuk janë të përputhshme.
5) Formatet AAC DRM dhe AAC Lossless nuk mbështeten.

Shënim
- Disa skedarë mund të mos luhen në varësi të formatit, kodimit ose kushteve të regjistrimit.
- Disa pajisje USB mund të mos funksionojnë me këtë sistem.
- Sistemi mbështet Nivelin 1/Nivelin 2 të ISO 9660 ose Joliet në DATA CD.
- Sistemi mbështet UDF (Universal Disk Format) në DATA DVD.
- Sistemi mbështet FAT12, FAT16 dhe FAT32 në pajisje USB.
- Sistemi mund të njohë skedarët ose dosjet e mëposhtme në DATA DVD, DATA CD dhe pajisje USB:
  – deri në 300 dosje
  – deri në 648 skedarë
- Për leximin e skedarëve mund të duhet kohë në rastet e mëposhtme:
  – kur ka shumë dosje ose skedarë.
  – kur kapaciteti i memories së pajisjes USB që po përdorni është tepër i madh.
  – kur kapaciteti i pajisjes USB që po përdorni është i fragmentuar.

Shpaketimi

Kontrollimi i artikujve të dhënë
- Njësia kryesore (1)
- Altoparlantët (5)
- Telekomanda (1)
- Nën-vuferi (1)
- Antena FM me tel (ajrore) (1)
- Bateri R6 (përmasa AA)* (2)
- Kordoni video** (1)
- Kablloja HDMI e shpejtësisë së lartë** (1)
- Udhëzimet e përdorimit (ky manual)

* Vetë modelet amerikane.
** Kablloja HDMI e shpejtësisë së lartë (High Speed HDMI) dhe kordoni video përfshihen vetëm në disa zona.

Përgatitja e telekomandës

Futni dy bateri R6 (përmasa AA) në mënyrë që polet e baterive ⊕ dhe ⊖ të përputhen me shenjat brenda folesë.



Lidhja e altoparlantëve

Kujdes
Mos përdorni altoparlantë të tjerë përveç atyre që jepen së bashku me këtë sistem.
Futni kordonët e altoparlantëve në mënyrë që të përputhen me ngjyrën e terminaleve SPEAKERS të njësisë.

Paneli i pasmë i njësisë kryesore



Shënim
- Lidhni kordonin e altoparlantit me tubin e ngjyrosur me +.



Lidhja e televizorit

Në varësi të foleve për fisha në televizorin ose dekoderin tuaj, zgjidhni mënyrën e lidhjes audio dhe video.

Vetëm kur lidhni me një televizor
Televizori ka fole *4 AUDIO OUT:



Kur lidhni një televizor dhe një dekoder/PlayStation®3
Televizori ka fole AUDIO OUT:



Televizori nuk ka fole AUDIO OUT:



Lidhja e një kordoni video dhe një kordoni audio
Zgjidhni *1 ose *2 për lidhjen video bazuar në foletë në televizor.

Audio ⇦ Video ➡



*1 Jepet vetëm në disa zona. Kjo është lidhja bazë përmes kordonit të videos (i verdhë).
*2 Jepet vetëm në disa zona. Cilësia e pamjes do të përmirësohet krahasuar me një kordon videoje.
*3 Shitet veç. Për të dëgjuar audion e televizorit përmes sistemit, lidheni me një kordon audio (i bardhë dhe i kuq).
*4 Nëse televizori juaj nuk ka fole për fisha për dalje audio AUDIO OUT, zëri i televizorit nuk ka dalje përmes këtij sistemi.

Lidhja e antenës FM me tel (ajrore)



Shënim
- Gjeni një pikë dhe një orientim që ofron marrje të mirë sinjali dhe më pas vendosni antenën.
- Vendoseni antenën larg nga kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik), kabllot e tjera dhe objektet metalike si p.sh. dritaret.

Gjatë instalimit të altoparlantëve në mur

Kujdes
- Kontaktoni me një dyqan lëndësh ndërtimi ose montues për informacion në lidhje me materialin e murit ose vidhat që do të përdoren.
- Përdorni vidha që janë të përshtatshme për materialin e murit dhe forcën e tij. Duke qenë se muret prej gipsi janë veçanërisht të brishtë, vidhat montojini mirë te një tra. Instalojini altoparlantët mbi një mur vertikal dhe të sheshtë të përforcuar.
- Sony nuk është përgjegjës për aksidentet ose dëmtimet e shkaktuara nga instalimi i pasaktë, forca e pamjaftueshme e murit ose montimi i pasaktë i vidhave, fatkeqësitë natyrore, etj.

1 Përgatitni vidha (të paofruara) që janë të përshtatshme për vrimën në pjesën e pasme të secilit altoparlant. Shihni figurat më poshtë.



Vrima në pjesën e pasme të altoparlantit



2 Shtrëngoni vidhat në mur, më pas varni altoparlantin në mur.

Thellësia e vidhave të shtrënguara





Konfigurimi i sistemit të ngjyrave

1 Lidhni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik).

2 Ndizni njësinë kryesore dhe televizorin.



3 Shtypni në mënyrë të përsëritur FUNCTION ose DVD/CD për të kaluar funksionin në DVD/CD.
Riprodhimi nis automatikisht nëse është ngarkuar një disk me një funksion riprodhimi automatik. Shtypni ■ dy herë për të ndaluar riprodhimin.

4 Ndryshojeni selektorin e hyrjes në televizorin tuaj që të shfaqë „Home Theatre System".

5 Shtypni SETUP në modalitetin e ndalimit.
Shfaqet Setup Menu (Menyja e konfigurimit).

6 Shtypni ←/→ në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur [Preference Page] (Faqen e preferencave), më pas shtypni ⊕.

7 Shtypni ↑/↓ në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur [TV Type] (Lloji i TV), më pas shtypni ⊕.

8 Shtypni ↑/↓ në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur [PAL] ose [NTSC] nga lista që shfaqet, më pas shtypni ⊕.

9 Shtypni SETUP për të fikur Setup Menu (Menynë e konfigurimit).

Shënim
- Pamja në ekranin e televizorit tuaj mund të ndërpritet për një çast pas ndryshimit të sistemit të ngjyrave siç përshkruhet më lart.

Pjesët dhe kontrollet

Paneli i përparmë



1 I/⏻ (ndezur/në gatishmëri)
Ndez njësinë, ose e vendos atë në modalitet gatishmërie.

2 Butonat e përdorimit të luajtjes
⏏ (hap/mbyll)
Hap ose mbyll sirtarin e diskut.
► (luaj)
Nis ose rinis riprodhimin (rifillon luajtjen).
■ (ndal)
Ndalon riprodhimin dhe ruan në kujtesë pikën e ndalimit (pikën e rifillimit).
Pika e rifillimit për një titull/këngë është pika e fundit që keni luajtur.
FUNCTION
Zgjedh burimin e riprodhimit.

3 VOLUME –/+
Rregullon volumin e sistemit.

4 Porta ψ (USB)
Përdoret për lidhjen e një pajisjeje USB.

5 Sirtari i diskut

6 Ekrani i panelit të përparmë

7 (sensori i telekomandës)

Paneli i pasmë



1 Terminalet SPEAKERS

2 Foletë HDMI OUT

3 Foleja VIDEO OUT

4 Foletë TV/CABLE (AUDIO IN)

5 Foleja FM ANTENNA

Telekomanda



SHIFT
Shtypni dhe mbani shtypur këtë buton për të përdorur butonat me etiketa me tekst në ngjyrë të purpurt.
TV INPUT*
E kalon burimin e hyrjes së televizorit mes sinjalit televiziv dhe burimeve të tjera hyrëse.

BRAVIA Sync
ONE-TOUCH PLAY
Aktivizon luajtjen me një prekje.
TV I/⏻ (ndezur/në gatishmëri)*
Ndez televizorin, ose e vendos atë në modalitet gatishmërie.
I/⏻ (ndezur/në gatishmëri)
Ndez sistemin, ose e vendos atë në modalitet gatishmërie.
Butonat e zgjedhjes së funksionit
Zgjedhin burimin e riprodhimit.
DVD/CD
FM
USB
TV/CABLE
FUNCTION
Zgjedh funksionet në sekuencë.
REPEAT
Aktivizon modalitetin e riprodhimit me përsëritje/përzierje.
SURROUND
Zgjedh modalitetin e daljes audio rrethuese.
EQ
Zgjedh modalitetin e ekuilizatorit.
AUDIO
Zgjedh formatin/pjesën audio dhe modalitetin FM.
SUBTITLE
Zgjedh gjuhën e titrave kur disponohen titra shumëgjuhësh.
ANGLE
Kalon në këndë të tjera shikimi kur në një DVD VIDEO janë regjistruar disa këndë.
Butonat e numrave
Vendos numrat e titujve/kapitujve, paravendos stacionet e radios, etj.
PROGRAM
Aktivizon luajtjen e programeve dhe paravendos stacionet e radios.
SLEEP
Vendos kohëmatësin e fjetjes.
DVD TOP MENU
Hap menynë kryesore të DVD-së.
DVD MENU
Hap ose mbyll menynë e DVD-së.
MUTING
Mbyll përkohësisht zërin.
←/↑/↓/→
Zhvendos theksimin te një artikull i shfaqur.
⊕ (ENTER)
Fut artikullin e zgjedhur.
VOLUME +/–
Rregullon volumin.
SETUP
Hap ose mbyll menynë e konfigurimit.
DISPLAY
Hap ose mbyll menynë e ekranit.
TIME
Shfaq informacionin e kohës gjatë riprodhimit.
Butonat e përdorimit të riprodhimit
⏮/⏭ (e mëparshme/tjetër)
◄◄/►► (përshpejtim prapa/ përshpejtim para)
◄I/I► (ngadalë)
Aktivizon ngadalësimin prapa/para kur **◄◄/►►** shtypet në modalitetin e pauzës.
❚❚ (pauzë)
► (luaj)
■ (ndal)
Butonat e përdorimit të radios
PRESET +/–
TUNING +/–

* Funksionon vetëm me televizorët Sony. Në varësi të televizorit tuaj, mund të mos jeni në gjendje të përdorni disa nga butonat.

Shënim
AUDIO IN
Ky buton nuk funksionon.

Vazhdon ➡

Luajtja e një disku

1 Shtypni DVD/CD.
Ju mund ta zgjidhni gjithashtu këtë funksion duke shtypur në mënyrë të përsëritur FUNCTION.

2 Shtypni ⏏ për të hapur sirtarin e diskut.

3 Vendosni një disk në sirtar, më pas shtypni ⏏.

Me anën e etiketës lart.

4 Shtypni ► për të nisur riprodhimin.

5 Shtypni VOLUME +/– për të rregulluar volumin.

Luajtja e skedarëve në një disk / pajisje USB

1 Shtypni DVD/CD ose USB.
- DVD/CD: Për disk.
- USB: Për pajisje USB.

Ju mund ta zgjidhni gjithashtu funksionin duke shtypur në mënyrë të përsëritur FUNCTION.

2 Ngarkoni burimin.

■ Për disk
Vendosni një disk në sirtar duke shtypur ⏏ për të hapur/mbyllur sirtarin e diskut.

■ Për një pajisje USB
Lidhni një pajisje USB me portën ψ (USB).



3 Shtypni ↑/↓ për të zgjedhur një dosje, më pas shtypni ⊕ dhe zgjidhni një skedar.

4 Shtypni ► për të nisur riprodhimin.

5 Shtypni VOLUME +/– për të rregulluar volumin.

Shënim
- Mos e shkëputni pajisjen USB gjatë punës. Për të shmangur dëmtimin e të dhënave ose dëmtimin e pajisjes USB, fikni sistemin kur lidhni ose shkëputni pajisjen USB.

Funksionet e tjera të riprodhimit

Për të ndryshuar këndet

Shtypni ANGLE gjatë riprodhimit për të zgjedhur këndin e dëshiruar. (Kjo aplikohet vetëm për DVD VIDEO.)

Për të shfaqur titrat

Shtypni SUBTITLE gjatë riprodhimit për të zgjedhur gjuhën dëshiruar të titrave. (Kjo aplikohet vetëm për DVD VIDEO.)

Për të ndryshuar zërin

Shtypni AUDIO në mënyrë të përsëritur gjatë riprodhimit për të zgjedhur sinjalin e dëshiruar audio.
– Kur sistemi luan një DVD VIDEO të regjistruar në disa formate audio (audio PCM, Dolby Digital ose MPEG), ju mund të ndryshoni formatin e audios. Nëse DVD VIDEO është regjistruar me pjesë në disa gjuhë, ju mund të ndryshoni edhe gjuhën.
– Me një VIDEO CD ose CD, ju mund të zgjidhni zërin nga kanali i majtë ose i djathtë dhe mund të dëgjoni zërin e kanalit të zgjedhur përmes altoparlantit të majtë dhe të djathtë njëkohësisht.

Për të luajtur një VIDEO CD me funksione PBC

Kur filloni të luani një VIDEO CD me funksione PBC (Playback control) shqip: kontroll i riprodhimit, shfaqet menyja për përzgjedhjen tuaj.

Për të luajtur pa përdorur funksionet PBC
Në modalitetin e ndalimit, shtypni dhe mbani shtypur SHIFT, më pas shtypni butonat e numrave për të zgjedhur numrin e pjesës që dëshironi.

Për të kërkuar një titull/kapitull/pjesë/skenë, etj.

■ Kur luani një DVD/VCD

1 Shtypni ▭ DISPLAY gjatë luajtjes.
Menyja Display shfaqet në ekranin e televizorit.

2 Shtypni ↑/↓ për të zgjedhur një opsion, më pas shtypni ⊕.

3 Shtypni dhe mbani shtypur SHIFT, më pas shtypni butonat e numrave për të kërcyer te opsioni i dëshiruar.

■ Kur luani një CD

1 Shtypni ▭ DISPLAY gjatë luajtjes.
Në ekranin e televizorit shfaqet ekrani i përzgjedhjes.

2 Shtypni dhe mbani shtypur SHIFT, më pas shtypni butonat e numrave për të zgjedhur pjesën e dëshiruar.

■ Kur luani një skedar video/muzike/foto

1 Shtypni ▭ DISPLAY gjatë luajtjes.
Në ekranin e televizorit shfaqet ekrani i përzgjedhjes.

2 Shtypni dhe mbani shtypur SHIFT, më pas shtypni butonat e numrave për të zgjedhur numrin e dëshiruar.

Për të luajtur sipas një rendi të programuar

Zgjidhni pjesët që do të luhen në rendin që dëshironi (vetëm për CD-të).

1 Shtypni dhe mbani shtypur SHIFT, më pas shtypni PROGRAM.
Në ekranin e televizorit shfaqet ekrani i menysë së programit (Program).

2 Shtypni dhe mbani shtypur SHIFT, më pas shtypni butonat e numrave për të zgjedhur pjesën e dëshiruar.

3 Shtypni ←/↑/↓/→ për të zgjedhur [Start] (Nis) për të luajtur programin.

Për të luajtur me përsëritje/përzierje, etj.

Shtypni REPEAT në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur modalitetin e dëshiruar.
Në ekranin e panelit të përparmë shfaqet modaliteti i zgjedhur.
- „REP CHP“: Përsërit kapitullin aktual.
- „REP TT“: Përsërit titullin aktual.
- „REP ALL“: Përsërit të gjithë titujt.
- „REP TRK“: Përsërit pjesën aktuale.
- „REP OFF“: Sistemi kthehet në modalitetin e riprodhimit normal.
- „SHUFFLE“: Luan përmbajtjen një herë në rend të rastësishëm derisa të jetë luajtur e gjithë përmbajtja.
- „SHUF REP“: Përsërit luajtjen me përzierje.
- „FOLDER“: Luan dosjen aktuale.
- „RANDOM“: Luan të gjithë skedarët në rend të rastësishëm.
- „SINGLE“: Luan skedarin aktual.
- „REP ONE“: Përsërit skedarin aktual.
- „REP FLD“: Përsërit dosjen aktuale.

Shënim
- Modalitetet që mund të zgjidhen dhe rendi i tyre ndryshojnë në varësi të diskut ose skedarit.

Zgjedhja e efektit zanor

Për të zgjedhur një cilësim ekuilizatori

Shtypni EQ për të shfaqur modalitetin aktual. Gjatë kohës që shfaqet modaliteti aktual, shtypni EQ në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet modaliteti i dëshiruar në ekranin e panelit të përparmë.
- „AUTO“: Zgjedh automatikisht modalitetin e filmit ose tingullit të muzikës bazuar në llojin e diskut.
- „MOVIE“: Bas i kënaqshëm dhe i fuqishëm, si dhe efekte zanore; rekomandohet për filmat.
- „MUSIC“: Diapazon i balancuar i lartë dhe i ulët; rekomandohet për muzikë.
- „TV“: Vokal i qartë, në diapazon të mesëm; rekomandohet për të parë drama ose komedi.
- „GAME“: Diapazon i shtuar i lartë dhe i ulët; rekomandohet për lojëra me aksion ose armë, etj.

Për të zgjedhur një cilësim rrethues

Shtypni SURROUND për të shfaqur modalitetin aktual. Gjatë kohës që shfaqet modaliteti aktual, shtypni SURROUND në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur modalitetin e daljes audio rrethuese.
Në ekranin e panelit të përparmë shfaqet modaliteti i zgjedhur.
- „MULTI“ (A.F.D. MULTI): Kur burimi është kanali 2, zëri del nga të gjithë altoparlantët.
- „STANDARD“ (A.F.D. STANDARD): Sistemi shpërfill formatin e zërit të burimit dhe e paraqet zërin siç ishte regjistruar/koduar.
- „DOLBY PL“ (PRO LOGIC): Kryen dekodim Dolby Pro Logic.
- „2CH ST“ (2CH STEREO): Të gjitha formatet shkrihen në 2 kanale.

Shënim
- Në varësi të transmetimit të riprodhimit, cilësimet rrethuese mund të mos kenë efekt.

Përdorimi i një sintonizuesi

Për të paravendosur stacionet e radios

Ju mund të paravendosni 20 stacione FM.
Ju mund të sintonizoheni në një prej atyre stacioneve thjesht duke zgjedhur numrin korrespondues të paravendosur.

1 Shtypni FM.

2 Shtypni dhe mbani shtypur TUNING +/– për 2 sekonda për të nisur sintonizimin derisa të gjeni stacionin e dëshiruar të radios.
„SEARCH +“ ose „SEARCH –“ shfaqen në ekranin e panelit të përparmë derisa të gjendet një stacion radioje me fuqi të mjaftueshme sinjali.

3 Shtypni dhe mbani shtypur SHIFT, më pas shtypni PROGRAM.
„P 01“ pulson në ekranin e panelit të përparmë.

4 Shtypni dhe mbani shtypur SHIFT, më pas shtypni butonat e numrave për të zgjedhur një numër të paravendosur.

5 Shtypni ⊕ për të ruajtur frekuencën e stacionit.

Për të zgjedhur një stacion radioje të paravendosur

1 Shtypni FM.

2 Shtypni PRESET +/– për të zgjedhur një numër të paravendosur.
Gjithashtu mund të zgjidhni një numër të paravendosur duke shtypur dhe mbajtur shtypur SHIFT, më pas duke shtypur butonat e numrave.

Nëse një program FM është i zhurmshëm, mund të zgjidhni marrjen mono. Nuk do të ketë efekt stereo, por do të përmirësohet marrja.

Shtypni AUDIO.
„STEREO“: Marrja stereo.
„MONO“: Marrja mono.

Funksione të dobishme

Mbi funksionin Control for HDMI (kontrolli për HDMI) („BRAVIA“ Sync)

Ju mund të kontrolloni një televizor të përputhshëm me funksionin Control for HDMI duke e lidhur atë me sistemin përmes një kablloje HDMI.

Veçoritë e disponueshme
- Luajtja me prekje
  Me një prekje të ONE-TOUCH PLAY në telekomandë, sistemi dhe televizori ndizen automatikisht dhe hyrja e televizorit kalon te sistemi; riprodhimi i një disku nis automatikisht.
- Fikja e sistemit
  Kur fikni televizorin duke përdorur butonin I/⏻ në telekomandën e televizorit ose TV I/⏻ në telekomandën e sistemit, sistemi fiket automatikisht.
- Kontrolli i sistemit audio
  Mund të kaloni daljen audio në altoparlantët e televizorit ose në altoparlantët e këtij sistemi përmes menysë së televizorit.

Kohëmatësi i fjetjes.

Ju mund të vendosni sistemin të fiket në një kohë të caktuar, në mënyrë që të flini gjumë duke dëgjuar muzikë.

Shtypni dhe mbani shtypur SHIFT, më pas shtypni SLEEP.
Sa herë që shtypni këtë buton, ekrani i minutave (koha e mbetur) ndryshon me nga 10 minuta.
Në ekranin e panelit të përparmë shfaqet numërimi së prapthi i 20 sekondave të fundit derisa njësia fiket.

Për të kontrolluar kohën e mbetur
Shtypni dhe mbani shtypur SHIFT dhe SLEEP për 3 sekonda. Në ekranin e panelit të përparmë shfaqet koha e mbetur derisa njësia fiket.

Për të anuluar funksionin e kohëmatësit të fjetjes
Shtypni dhe mbani shtypur SHIFT, më pas shtypni në mënyrë të përsëritur SLEEP derisa në ekranin e panelit të përparmë të shfaqet „OFF“.

Për të parë informacion mbi diskun

Mund të kontrolloni kohën e luajtjes dhe kohën e mbetjes së titullit, kapitullit ose pjesës aktuale.

Shtypni dhe mbani shtypur SHIFT, më pas shtypni në mënyrë të përsëritur TIME.
Sa herë që shtypni dhe mbani shtypur SHIFT, dhe më pas shtypni TIME gjatë luajtjes së diskut, artikulli i shfaqur ndryshon në varësi të diskut.

Përdorimi i ekranit të konfigurimit

Ju mund të kryeni rregullime të ndryshme të artikujve siç janë figura dhe zëri.
Artikujt e shfaqur ndryshojnë në varësi të modelit për atë vend.
Cilësimi i parazgjedhur nënvizohet.

1 Shtypni DVD/CD, më pas nxirrni diskun.

2 Shtypni SETUP.
Shfaqet menyja e konfigurimit.

3 Shtypni ←/→ për të zgjedhur një nga kategoritë e menysë së konfigurimit, më pas shtypni ⊕.

4 Shtypni ↑/↓ për të zgjedhur një artikull për konfigurim, më pas shtypni → or ⊕.

5 Zgjidhni opsionin që dëshironi të ndryshoni dhe shtypni ⊕ për ta konfirmuar dhe për t'u kthyer në artikullin e zgjedhur më parë.

6 Shtypni SETUP për të fikur menynë.



General Setup Page (Faqja e konfigurimit të përgjithshëm)

■ [TV Display] (Ekrani i televizorit)
[16:9]: Zgjidhni këtë kur lidhni një televizor me ekran të gjerë ose një televizor me një funksion për modalitet të gjerë.

[4:3 Letter Box] (Kuti me kashe): Shfaq një pamje të gjerë me shirita të zinj lart dhe poshtë.

[4:3 Pan Scan] (Panoramike dhe skanim): Shfaq një pamje me lartësi të plotë, me anë të prera.



■ [OSD Lang] (On-Screen Display) (Gjuha e shfaqjes së ekranit)
Ju mund të ndërroni gjuhën e paraqitjes në ekranin e televizorit.

■ [Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI)
Ky funksion është i disponueshëm kur lidhni sistemin dhe një televizor të përputhshëm me funksionin Control for HDMI përmes një kablloje HDMI.
[On] (Ndezur): Mund të përdorni në mënyrë reciproke komponentë që janë të lidhur përmes një kablloje HDMI.
[Off] (Fikur): Fikur.

■ [HDMI Audio] (Audio HDMI)
Ky cilësim kërkohet vetëm nëse përdorni fishën HDMI OUT për një lidhje audio.
[Off] (Fikur): Fik daljen audio HDMI. Mund të vazhdoni të dëgjoni tingullin përmes sistemit të altoparlantëve.
[All] (Të gjitha): Formati i daljes audio HDMI do të jetë i njëjti si i transmetimit të audios që po luhet. Nëse formati audio i riprodhimit nuk mbështetet, dalja audio do të ndryshohet automatikisht në PCM.
[PCM] (Kontrolli i riprodhimit): Dalja audio HDMI do të shkrihet në PCM lineare (2 kanale).

■ [Screen Saver] (Ruajtësi i ekranit)
[On] (Ndezur): Imazhi i ruajtësit të ekranit shfaqet nëse nuk e përdorni sistemin për rreth 15 minuta.
[Off] (Fikur): Fikur.

■ [Last Memory] (Memoria e fundit)
Ky sistem kujton pikën ku ndërpretë diskun herën e fundit që e ka luajtur dhe rifillon riprodhimin nga ajo pikë herën e fundit që futni të njëjtin disk.
[On] (Ndezur): Sistemi ruan në memorie pikat e rifillimit.
[Off] (Fikur): Sistemi nuk i ruan në memorie pikat e rifillimit. Riprodhimi rinis në pikën e rifillimit vetëm për diskun aktual në njësi.

Shënim
- Kur memoria e rifillimit është plot, fshihet pika e rifillimit të riprodhimi për diskun më të hershëm të ruajtur.

■ [Auto Standby] (Gatishmëri automatike)
[On] (Ndezur): Kalon në modalitetin e gatishmërisë automatikisht kur është në modalitetin e ndalimit, pauzës, pa disk, ose të nxjerrjes për më shumë se 30 minuta.
[Off] (Fikur): Njësia nuk kalon automatikisht në modalitet gatishmërie.

Speaker Setup Page (Faqja e konfigurimit të altoparlantëve)

■ [Level] (Niveli)
Ju mund të rregulloni nivelin e zërit të të gjithë altoparlantëve dhe nën-vuferit.
[L] (Majtas): Rregullon nivelin e zërit të altoparlantit të majtë. Është e mundur që të rregullohet parametri nga -6.0 dB deri +0.0 dB.
[C] (Qendër): Rregullon nivelin e zërit të altoparlantit qendror. Është e mundur që të rregullohet parametri nga -6.0 dB deri +6.0 dB.
[R] (Djathtas): Rregullon nivelin e zërit të altoparlantit të djathtë. Është e mundur që të rregullohet parametri nga -6.0 dB deri +0.0 dB.
[SR] (Rrethues djathtas): Rregullon nivelin e zërit të altoparlantit të djathtë rrethues. Është e mundur që të rregullohet parametri nga -6.0 dB deri +6.0 dB.
[SL] (Rrethues majtas): Rregullon nivelin e zërit të altoparlantit të majtë rrethues. Është e mundur që të rregullohet parametri nga -6.0 dB deri +6.0 dB.
[SW] (Nën-vuferi): Rregullon nivelin e zërit të nën-vuferit. Është e mundur që të rregullohet parametri nga -6.0 dB deri +6.0 dB.

■ [Distance] (Distanca)
Nëse lëvizni një nga altoparlantët, sigurohuni që të vendosni parametrat e distancës nga pozicioni i dëgjimit deri te altoparlantët.
[L/R] (Majtas/Djathtas): Rregullon distancën e altoparlantëve të majtë/djathtë. Është e mundur që të rregullohet parametri nga 1.0 m deri 7.0 m (3 deri 23 ft).
[C] (Qendër): Rregullon distancën e altoparlantit qendror. Ky parametër mund të vendoset mes 1.6 m (5 ft) më të shkurtër deri barabar me cilësimin e kanalit L/R.

[SL/SR] (Rrethues majtas / rrethues djathtas): Rregullon distancën e altoparlantëve rrethues të majtë/djathtë. Ky parametër mund të vendoset mes 5.0 m (16 ft) më të shkurtër deri barabar me cilësimin e kanalit L/R.

■ [Center Speaker] (Altoparlanti qendror)
[On] (Ndezur): Aktivizon altoparlantin qendror.
[Off] (Fikur): Çaktivizon altoparlantin qendror.

■ [Sur. Speaker] (Altoparlanti rrethues)
[On] (Ndezur): Aktivizon altoparlantët rrethues.
[Off] (Fikur): Çaktivizon altoparlantët rrethues.

■ [Test Tone] (Sinjali testues)
Altoparlantët lëshojnë një sinjal testues për të vendosur nivelin.
[On] (Ndezur): Altoparlantët do të lëshojnë sinjalin testues.
[Off] (Fikur): Altoparlantët nuk do të lëshojnë sinjalin testues.

Këshillë
- Për të rregulluar volumin e të gjithë altoparlantëve, shtypni VOLUME +/– në njësi ose në telekomandë.
- Shtypni ←/↑/↓/→ në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur altoparlantin dhe nivelin ose distancën e dëshiruar.

Video Setup Page (Faqja e konfigurimit të videos)

■ [HDMI Resolution] (Rezolucioni HDMI)
Mund të zgjidhni llojin e sinjalit video që del nga foleja HDMI OUT.
[Auto] (Automatik): Sistemi nxjerr sinjalin optimal video për televizorin e lidhur.
[480p/576p]: Sistemi nxjerr sinjale video 720 × 480p* ose 720 × 576p*.
[720p]: Sistemi nxjerr sinjale video 1280 × 720p*.

[1080i]: Sistemi nxjerr sinjale video 1920 × 1080i*.
[1080p]: Sistemi nxjerr sinjale video 1920 × 1080p*.
* i: e gërshetuar, p: progresive

Preference Page (Faqja e preferencave)

■ [TV Type] (Lloji i televizorit)
Cilësimi i parazgjedhur i llojit të televizorit ndryshon në varësi të zonës.
[PAL]: Për një televizor me sistem PAL.
[NTSC]: Për një televizor me sistem NTSC.

■ [Audio] (Audio)
Mund të zgjidhni gjuhën e preferuar të audios për DVD-të me disa kolona zanore.

■ [Subtitle] (Titrat)
Ju mund të ndërroni gjuhën e titrave të regjistruara në një DVD VIDEO.

■ [Disc Menu] (Menyja e diskut)
Ju mund të ndërroni gjuhën e menysë së një disku.

■ [Parental] (Kontrolli prindëror)
Ju mund të kufizoni riprodhimin e DVD-ve që kanë klasifikim për të rritur. Skenat mund të bllokohen ose mund të zëvendësohen me skena të tjera.

1 Shtypni ↑/↓ për të zgjedhur një nivel klasifikimi nga 1 në 8 ose [Off] (Fikur), më pas shtypni ⊕.

2 Shtypni dhe mbani shtypur SHIFT, më pas shtypni butonat e numrave për të vendosur fjalëkalimin tuaj me 6 shifra.

■ [Default] (E parazgjedhur)
Kjo veçori ju mundëson të rivendosni në parazgjedhjen e fabrikës të gjitha opsionet e menysë së konfigurimit dhe cilësimet personale, përveç fjalëkalimit për artikujt [Password] (Fjalëkalimi) dhe [Parental] (Kontrolli prindëror).
Shtypni ⊕ për të konfirmuar rivendosjen e parazgjedhjeve.

Password Setup Page (Faqja e konfigurimit të fjalëkalimit)

■ [Password] (Fjalëkalimi)
Fjalëkalimi i parazgjedhur është „000000“.
Për të ndryshuar fjalëkalimin:

1 Shtypni dhe mbani shtypur SHIFT, më pas shtypni butonat e numrave për të vendosur „000000“ ose fjalëkalimin e fundit të vendosur prej 6 shifrash në seksionin [Old Password] (Fjalëkalimi i vjetër).

2 Shtypni dhe mbani shtypur SHIFT, më pas shtypni butonat e numrave për të vendosur një fjalëkalim të ri prej 6 shifrash në seksionin [New Password] (Fjalëkalimi i ri).

3 Shtypni dhe mbani shtypur SHIFT, më pas shtypni butonat e numrave për të vendosur sërish fjalëkalimin e ri prej 6 shifrash në seksionin [Confirm PWD] (Konfirmo fjalëkalimin) për të konfirmuar të dhënat.

4 Shtypni [OK] për të dalë nga menyja.

Masat paraprake

Mbi vendosjen
- Kur volumi është i lartë për periudha të gjata kohore, kur preket mobilia është e nxehtë. Ky nuk është keqfunksionim. Megjithatë, duhet shmangur prekja e mobilies. Mos e vendosni sistemin në një hapësirë të kufizuar ku ka pak ventilim, duke qenë se kjo mund të shkaktojë mbinxehje.
- Mos e instaloni sistemin pranë burimeve të nxehtësisë siç janë radiatorët ose tubacionet e ajrit, ose në një vend ku bie drita e drejtpërdrejtë e diellit, ku ka pluhur të tepërt, dridhje mekanike ose tronditje.
- Mos e instaloni sistemin në një pozicion të pjerrët. Ai është projektuar që të përdoret vetëm në pozicion horizontal.
- Mos vendosni objekte të rënda mbi sistem.

Mbi përdorimin
- Nëse sistemi sillet direkt nga një vend i ftohtë në një vend të ngrohtë, ose vendoset në një dhomë shumë të lagësht, lagështira mund të kondensohet mbi lentet jashtë njësisë. Nëse ndodh kjo, sistemi mund të mos punojë siç duhet. Në këtë rast, hiqni diskun dhe lëreni sistemin të ndezur për rreth gjysmë ore derisa të avullojë lagështira.
- Nëse brenda në mobilie bie diçka, njësia duhet të hiqet nga priza dhe duhet të kontrollohet nga një personel i kualifikuar përpara se të vihet sërish në punë.

Mbi pastrimin
- Pastroni mobilien, panelin dhe kontrollet me një pëlhurë të butë të njomur paksa me një solucion larës të butë. Mos përdorni asnjë lloj pastruesi abraziv, tela fërkimi ose tretës si alkooli ose benzina.
  Nëse keni pyetje ose probleme në lidhje me sistemin tuaj, ju lutemi kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

Mbi pastrimin e disqeve, pastruesit e disqeve/lenteve
- Mos përdorni disqe pastruese ose pastrues disqesh/lentesh (duke përfshirë llojet e lëngshme ose me spërkatje). Këto mund të shkaktojnë keqfunksionim të aparaturës.

Mbi ngjyrën e televizorit tuaj

> **SHËNIM I RËNDËSISHËM**
> Kujdes: Ky sistem është në gjendje të mbajë për një kohë të pacaktuar në ekranin e televizorit një foto ose një imazh të palëvizshëm video. Nëse këtë foto ose imazh të palëvizshëm video e lini të shfaqet në televizor për një periudhë të tejzgjatur kohore, rrezikoni dëmtimin e përhershëm të ekranit të televizorit tuaj. Të prekshëm nga kjo janë veçanërisht televizorët me projeksion.

Mbi lëvizjen e sistemit
Përpara se të lëvizni sistemin, sigurohuni që brenda nuk ka disk dhe hiqni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) nga priza e murit (rrjeti).

Mbi përdorimin e disqeve
- Për të mbajtur të pastër diskun, kapeni diskun nga cepat e tij. Mos e prekni sipërfaqen.
- Mos ngjisni letër ose shirit mbi disk.
- Mos e ekspozoni diskun ndaj dritës së drejtpërdrejtë të diellit ose burimeve të nxehtësisë siç janë tubacionet e ajrit të nxehtë, ose mos e lini në një makinë të parkuar në dritë të drejtpërdrejtë dielli duke qenë se brenda makinës temperaturat mund të rriten në mënyrë të konsiderueshme.

Mbi pastrimin e disqeve
- Përpara luajtjes, pastroni diskun me një pëlhurë pastrimi.
  Fshijeni diskun duke filluar nga qendra drejt skajeve.
- Mos përdorni tretës si benzina, holluesit, pastruesit që blihen në dyqan, ose sprejët antistatikë që përdoren për disqet LP prej vinili.

Ky sistem mund të luajë vetëm një disk standard të rrumbullakët. Përdorimi i disqeve jo standarde ose jo rrethore (p.sh. në formë kartoline, zemre apo ylli) mund të shkaktojë keqfunksionim.
Mos përdorni një disk që ka të bashkëngjitur një aksesor tregtar si etiketë apo unazë.

Mbi rrezatimin e nxehtësisë
Për shkak të llojit të hollë të dizajnit të njësisë qendrore, mund të ndieni nxehtësi në pjesën e sipërme të njësisë. Kjo është gjë normale. Nëse keni pyetje ju lutemi kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

Zgjidhja e problemeve

Nëse ju ndodh një nga vështirësitë e mëposhtme gjatë përdorimit të sistemit, përdorni këtë udhëzues për zgjidhjen e problemeve për t'ju ndihmuar të zgjidhni problemin përpara se të kërkoni riparime.
Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.
Vini re se nëse personeli i shërbimit ndërron disa pjesë gjatë riparimit, ata mund t'i mbajnë këto pjesë.

Energjia

Energjia nuk është e ndezur.
- Kontrolloni që kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) të jetë lidhur mirë.

Zëri

Zëri nuk del nga altoparlantët rrethues.
- Shtypni SURROUND vazhdimisht dhe zgjidhni „MULTI“ (A.F.D. MULTI) që zëri të dalë nga të gjithë altoparlantët. (Në varësi të mjetit, zëri mund të mos dalë nga altoparlantët rrethues.)

Artikujt e [Speaker Setup Page] (Faqes së konfigurimit të altoparlantëve) nuk mund të ndryshohen.
- Shtypni DVD/CD, më pas nxirrni diskun.

Nuk ka zë. Dëgjohet gumëzhitje ose zhurmë e madhe.
- Hiqni kordonët e altoparlantëve nga terminalët SPEAKERS, drejtoni dhe zgjatni zonën e kontaktit për çdo kordon altoparlanti, më pas rilidhni kordonët e altoparlantëve me terminalët SPEAKERS.
- Pastroni diskun.

Zëri humb efektin stereo kur luani një VIDEO CD ose CD.
- Vendosni cilësimet audio në [Stereo] (Stereo) duke shtypur AUDIO.

Figura

Nuk ka figurë.
- Kordonët që lidhin videon nuk janë lidhur mirë.
- Njësia nuk është e lidhur me folenë e duhur të hyrjes së televizorit.
- Sistemi nuk është zgjedhur përmes hyrjes video të televizorit.
- Kontrolloni mënyrën e daljes në sistemin tuaj.

Megjithëse vendosni raportin e pamjes në [TV Display] (Ekranin e televizorit) të [General Setup Page] (Faqes së konfigurimit të përgjithshëm), figura nuk e mbush ekranin e televizorit.
- Raporti i pamjes në disk është i caktuar paraprakisht.

Ka parregullsi ngjyrash në ekranin e televizorit.
Altoparlantët e sistemi përmbajnë pjesë magnetike, për këtë arsye ndodh ndryshime të ngjyrave. Kur ka parregullsi ngjyrash në ekranin e televizorit, kontrolloni artikujt e mëposhtëm.
- Vendosini altoparlantët të paktën 0.3 metra (1.0 ft) nga aparati i televizorit.
- Nëse vazhdojnë parregullsitë e ngjyrave, fikni një herë aparatin e televizorit, më pas ndizeni sërish pas 15 deri 30 minutash.
- Rivendosini altoparlantët më larg nga aparati juaj i televizorit.

Cilësimi [TV Type] (Lloji i televizorit) nuk përputhet me televizorin tuaj.
[TV Type] (Lloji i televizorit) mund të rivendoset sipas procedurës së mëposhtme:
1. Shtypni ⏏ për të nxjerrë diskun.
2. Shtypni ▭ DISPLAY.
3. Shtypni ⊕.

Do të rivendoset [TV Type] (Lloji i televizorit).

Përdorimi

Në ekranin e panelit të përparmë shfaqet „PROTECT“.
- Lidhni mirë të gjitha kanalet me terminalet e tyre korresponduese SPEAKERS.
- Shtypni I/⏻ për të fikur sistemin, dhe kontrolloni artikujt e mëposhtëm pasi të zhduket „STANDBY“:
  – Mos bëjnë qark të shkurtër kordonët e + dhe – të altoparlantëve?
  – A po bllokon ndonjë gjë vrimat e ajrimit të sistemit?
- Pasi të kontrolloni artikujt e mëposhtëm dhe të rregullon problemet, ndizni sistemin.
  Nëse shkaku i problemit nuk mund të gjendet edhe pas kontrollimit të të gjithë artikujve të mësipërm, kontaktoni me shitësin më të afërt Sony.

Disku nuk mund të nxirret dhe në ekranin e panelit të përparmë shfaqet „LOCKED“.
- Kontaktoni shitësin Sony ose shërbimin lokal të autorizuar Sony.

Stacionet e radios nuk mund të sintonizohen.
- Kontrolloni që antena (ajrore) të jetë lidhur mirë. Rregulloni antenën (ajrore) ose lidhni një antenë të jashtme (ajrore) nëse është e nevojshme.

Disku nuk luan.
- Kodi rajonal në DVD nuk përputhet me sistemin.
- Brenda njësisë është kondensuar lagështirë dhe mund të shkaktojë dëmtim të lenteve. Hiqni diskun dhe lëreni njësinë të ndezur për rreth gjysmë ore.

Nuk mund të luhet një DATA CD/ DATA DVD.
- DATA CD nuk është regjistruar në Nivelin 1/Nivelin 2 të ISO 9660 ose Joliet.
- DATA DVD nuk është regjistruar në UDF (Universal Disk Format).

Nuk mund të luhet një skedar imazhi JPEG.
- Është më i madh se 2,048 (gjerësi) × 1,536 (lartësi) në modalitet normal, ose më shumë se 2,000,000 piksel në format progresiv i cili përdoret kryesisht në faqet e internetit.

Nuk mund të luhet një skedar video.
- Rezolucioni i skedarit video është më i madh se 720 (gjerësi) × 576 (lartësi).

Emri i dosjes ose skedarit nuk shfaqet saktë.
- Sistemi mund të shfaqë vetëm numra dhe shkronjat e alfabetit. Karakteret e tjera shfaqen si [_].

Një disk nuk fillon të luhet nga fillimi.
- Është zgjedhur rifillimi i luajtjes. Kur është i ndaluar, shtypni ■ dhe më pas nisni riprodhimin.
- Është zgjedhur luajtja e programit. Kur është i ndaluar, shtypni ■ dhe më pas nisni riprodhimin.
- Është zgjedhur luajtja me përzierje. Kur është i ndaluar, shtypni ■ dhe më pas nisni riprodhimin.

Sistemi nuk punon normalisht.
- Shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) nga priza e murit (rrjeti), më pas rilidheni pas disa minutash.

Funksioni Control for HDMI (kontrolli për HDMI) nuk funksionon.
- Vendosni cilësimin e [Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI) në [General Setup Page] (Faqen e konfigurimit të përgjithshëm) në [On] (Ndezur).
- Sigurohuni që komponenti i lidhur të jetë i përputhshëm me funksionin Control for HDMI (Kontrolli për HDMI).
- Kontrolloni cilësimin e komponentit të lidhur për funksionin Control for HDMI (Kontrolli për HDMI). Referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me komponentin.

Pajisje USB

Në ekranin e panelit të përparmë shfaqet „OVERLOAD“.
- Shkëputni pajisjen USB nga porta ψ (USB). Sigurohuni që të mos ketë probleme me pajisjen USB.

Pajisja USB (skedar audio/skedar imazhi JPEG) nuk mund të luhet.
- Skedarët e shifruar ose të mbrojtur me fjalëkalime, etj., nuk mund të luhen.
- Në pajisjen USB nuk ka asnjë skedar që mund të luhet.

Specifikimet

SPECIFIKIMET E FUQISË AUDIO
për modelet amerikane
DALJA E FUQISË DHE DISTORSIONI TOTAL HARMONIK:
(FTC)
I përparmë majtas + I përparmë djathtas
Me ngarkesa 8 om, me të dyja kanalet në funksionim, nga 180 - 20,000 Hz; 30 wat nominale për fuqi minimale RMS në kanal, me jo më pak se 1% distorsion total harmonik nga 250 mili wat në dalje nominale.

Seksioni i amplifikatorit
DALJA E FUQISË (nominale):
I përparmë majtas + I përparmë djathtas
30 W + 30 W (në 8 om, 1 kHz, 1% THD)
DALJA E FUQISË (e referuar):
I përparmë majtas / I përparmë djathtas / Qendror / Rrethues majtas / Rrethues djathtas: 50 W (për kanal në 8 om, 1 kHz)
nën-vufer: 50 W (në 8 om, 100 Hz)

Hyrjet
TV/CABLE : Foleja me kunja

Sistemi CD/DVD
Vetitë e diodës me laser
Kohëzgjatja e emetimit:
E vazhdueshme
Dalja laser*: Më pak se 44.6 μW
* Kjo dalje është masa e vlerës në një distancë prej 200 mm nga sipërfaqja e lentes së objektivit në bllokun marrës optik me hapje 7 mm.

Seksioni USB
Porta ψ (USB):
Rryma maksimale: 500 mA

Seksioni i sintonizuesit
Sistemi: Sintetizues dixhital PLL të kyçur me kuarc
Diapazoni i sintonizimit
Modelet e Amerikës së Veriut dhe Brazilit: 87.5 MHz - 108.0 MHz (hapa me nga 100 kHz)
Modelet e tjera: 87.5 MHz - 108.0 MHz (hapa me nga 50 kHz)
Antena: Antenë përcjellëse FM

Seksioni i videos
Daljet: VIDEO: Foleja me kunja
HDMI OUT: HDMI me 19 kunja

Altoparlantët
I përparmë
SS-TS121

Përmasat (afërsisht)	83 mm ×